

Vendim nr. 207 datë 25.07.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Marjana Semini,	Anëtare
Ilir Toska,	Anëtar

në datën 25.07.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 17 (F) 2025 të Regjistrimit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **FREDERIK BICI, ARJANIT BICI**, përfaqësuar nga avokatët Maksim Bajraktari dhe Elvis Spahiu, me prokurë të posaçme.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2025-355 (28), datë 28.01.2025 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 17, 18, 41, 42, 43, 124, pika 1, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, si dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Ilir Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesit janë përfshirë në një mosmarrëveshje pronësie për një sipërfaqe toke me shtetasin F.V. dhe në vijim me trashëgimtarët e tij. Familja e këtij shtetasi ka përfituar tokë në pronësi në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për tokën”, të ndryshuar, duke u pajisur nga Komisioni i Tokës i Komunës Kashar, në vitin 1994, me aktin e marrjes së tokës në pronësi për sipërfaqen 5200 m². Nga ana tjetër, në datën 19.11.2001 i njëjti komision ka pajisur familjen e shtetasit R.V. me një akt për marrjen në pronësi të tokës për sipërfaqen 3000 m², akt i cili është regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP), Tiranë në datën 08.02.2002. Në të njëjtën datë R.V. dhe bashkëshortja e tij A.V., nëpërmjet kontratës së shitblerjes nr. 1494/480 (*kontrata e shitblerjes*), këtë sipërfaqe toke ua kanë shitur kërkuesve, të cilët e kanë regjistruar në ZVRPP-në, Tiranë dhe janë pajisur me certifikatë pronësie në datën 26.03.2002. Në vijim, pas ndryshimit të destinacionit të tokës nga “arë” në “trull” dhe pasi janë pajisur në vitin 2003 me leje të organeve kompetente, kërkuesit kanë ndërtuar në atë tokë një objekt 1-katësh dhe 3-katësh.

2. Fillimisht procesi gjyqësor është vënë në lëvizje nga shtetasi F.V., por nuk ka të dhëna që mosmarrëveshja të jetë zgjidhur me vendim përfundimtar. Në vijim, trashëgimtarët e këtij shtetasi, në qershor 2006 i janë drejtuar gjykatës me padi, me të cilën, duke paditur kërkuesit (blerësit) dhe shitësit e tyre, kanë kërkuar konstatimin e pavlefshmërisë të kontratës së shitblerjes, çregjistrimin dhe fshirjen e pasurisë në emër të kërkuesve, si dhe detyrimin e të paditurve t’i njihnin pronarë të tokës “arë” me sipërfaqe 3200 m². Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka rrëzuar padinë me vendimin nr. 5390, datë 09.07.2007, i cili është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. 1992, datë 11.12.2008. Të dyja këto vendime më pas janë prishur nga Gjykata e Lartë me vendimin nr. 578, datë 22.10.2013 dhe çështja është dërguar për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë, me arsyetimin se gjykatat më të ulëta nuk i kanë dhënë përgjigje pretendimit kryesor që përbën dhe shkakun e padisë, atij të pronësisë, pasi ato edhe pse kanë pranuar mbivendosjen e titujve të pronësisë të palëve ndërgjyqëse kanë anashkaluar shqyrtimin dhe vlerësimin e ligjshmërisë së tyre. Në rigjykim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 4983, datë 21.04.2014, ka vendosur pushimin e çështjes, për shkak të mosparaqitjes në gjykim të palës paditëse.

3. Në datën 04.12.2014 trashëgimtarët e F.V. i janë drejtuar sërish gjykatës me kërkesëpadi me të njëjtin objekt, por duke shtuar edhe dy kërtime të tjera, konkretisht për lirin dhe dorëzimin e tokës dhe për pagimin e vlerës së përdorimit të saj. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 6161, datë 21.07.2015, ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë, deklarimin si absolutisht të pavlefshme të kontratës së shitblerjes dhe fshirjen nga regjistrat e ZVRPP-së, Tiranë të certifikatës së pronësisë të lëshuar në emër të kërkuesve, si dhe detyrimin e tyre të njohin palën paditëse si pronarë të ligjshëm të pasurisë tokë “arë” me

sipërfaqe 3000 m², duke urdhëruar edhe marrjen e masës së sigurimit të padisë, bllokimin e pasurisë në regjistrat e ZVRPP-së, Tiranë, me qëllim mostjetërsimin e saj deri në marrjen formë të prerë të vendimit. Për pjesën tjetër, për sa u përket kërkimeve për lirimin dhe dorëzimin e sendit dhe për pagimin e vlerës së përdorimit të tij, padia është rrëzuar. Ajo gjykatë, në mënyrë të përmbledhur, ka pranuar mbivendosjen e pronës së paditësve dhe asaj të mbajtur nga kërkuesit, si dhe se praktika e përfitimit të tokës nga shitësit e kërkuesve është shpallur e falsifikuar me vendim gjyqësor penal të formës së prerë. Nisur nga kjo, kontrata e shitblerjes në favor të kërkuesve është gjetur absolutisht e pavlefshme për shkakun se shitësit kishin tjetërsuar një pronë që nuk e kishin fituar në përputhje me ligjin. Për zgjidhjen e pasojave të kësaj pavlefshmërie, gjykata ka konsideruar vetëm njohjen e paditësve pronarë të tokës dhe fshirjen e regjistrimit të saj nga pronësia e kërkuesve. Për kërkimet e padisë për lirimin dhe dorëzimin e sendit dhe për pagimin e vlerës së përdorimit të tij gjykata është shprehur se padia nuk duhej pranuar për sa kohë kërkuesit vijonin të ishin posedues të ligjshëm të tokës në bazë të kontratës së shitblerjes deri sa vendimi i saj të merrte formë të prerë, por edhe se ata ishin pronarë të objektit të ndërtuar mbi të. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur ankim kërkuesit dhe ish-ZVRPP-ja, Tiranë, ndërsa paditësit kanë paraqitur apel kundërshtues.

4. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1009, datë 21.04.2017, ka ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke pranuar pjesërisht padinë dhe detyruar të paditurit R.V. dhe bashkëshorten e tij A.V. (shitësit) t'i paguanin palës paditëse vlerën e sipërfaqes së truallit 3000 m², sipas përcaktimeve të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1620, datë 26.11.2008 "Për miratimin e çmimeve të trojeve që ndodhen në të gjitha bashkitë dhe në disa komuna", ndërsa ka rrëzuar padinë për pjesën tjetër. Gjykata e apelit, në mënyrë të përmbledhur, ka pranuar si të drejtë përfundimin e gjykatës së shkallës së parë për pavlefshmërinë absolute të kontratës së shitblerjes, por jo për zgjidhjen e pasojave të kësaj pavlefshmërie. Sipas asaj gjykate, referuar nenit 106 të Kodit Civil (KC) dhe përfundimeve të vendimit unifikues nr. 5, datë 30.10.2012 të Gjykatës së Lartë (*vendimi unifikues nr. 5/2012*), ndërsa kërkuesit kanë qenë në mirëbesim në blerjen e tokës dhe në vijim kanë ndërtuar me leje një ndërtesë, vlera e së cilës është shumë herë më e madhe sesa vlera e tokës, bazuar në nenin 175, paragrafi 4, i KC-së, ata praktikisht dhe ligjërisht janë bërë pronarë edhe të tokës, ndaj nuk mund të detyroheshin të njihnin pronarë persona të tjerë, as ta lironin dhe dorëzonin atë dhe as të kthenin çfarë kishin paguar, ose vlerën reale të saj. E vetmja pasojë që mbetej për t'u zgjidhur, sipas saj, ishte kthimi në favor të paditësve të vlerës së tokës, detyrim që rëndonte mbi shitësit e paditur. Kundër këtij vendimi kanë ushtruar rekurs paditësit, ndërkohë që kërkuesit kanë paraqitur kundërrkurs.

5. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-355 (28), datë 28.01.2025, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Ai kolegji, në mënyrë të përmbledhur, ka arsyetuar se rregullimi i pasojave të pavlefshmërisë absolute të kontratës së shitblerjes nga gjykata e apelit nuk është në respektim të ligjit material, nenit 106 të KC-së, dispozitë e cila gjente zbatim vetëm në raport me pjesëmarrësit (subjektet) e një veprimi juridik dhe nuk mund të zbatohet për të rregulluar pasojat midis njëres prej palëve të veprimit juridik dhe një subjekti të tretë të cenuar. Po sipas tij, ai disponim nuk është as në respektim të ligjit procedural, nenit 6 të Kodit të Procedurës Civile (KPC), për sa kohë kapërcen kufijtë e kërimit të padisë. Në lidhje me përfundimin e gjykatës së apelit se kërkuessit janë bërë praktikisht dhe ligjërisht pronarë të truallit objekt gjykimi, sipas nenit 175, paragrafi 4, të KC-së, ai kolegji ka arsyetuar se gjykata e apelit i ka tejkaluar kufijtë e parimit të disponibilitetit, për sa kohë kërkuessit nuk kanë paraqitur padi ose kundërpadi për njohjen e së drejtës së pronësisë mbi truallin për shkak të tejkalimit të vlerës së ndërtesës të ndërtuar mbi të. Sipas kolegjit, ajo dispozitë, krahas ngritjes së ndërtesës në tokën e huaj me kushtin e mirëbesimit, kërkon edhe certifikimin e kësaj mënyre fitimi pronësie me vendim gjyqësor.

6. Në datën 26.05.2025 kërkuessit, përmes shërbimit postar, i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar më 04.06.2025.

II

Pretendimet e kërkuessve

7. **Kërkuessit**, në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar se vendimet e kundërshtuara u kanë cenuar:

7.1. *Të drejtën për një proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

7.1.1. *Së drejtës së aksesit dhe së drejtës për t'u dëgjuar e për t'u mbrojtur*, pasi Gjykata e Lartë nuk e ka shqyrtuar çështjen sipas procedurës që parashikonte ligji i kohës në momentin e paraqitjes së kërkesëpadisë, pra në seancë gjyqësore publike, në prani të palëve (përfaqësuesve të tyre), por ka ndjekur procedurën e gjykimit sipas ligjit në fuqi në kohën e shqyrtimit të çështjes, në një kohë kur ndryshimet e bëra KPC-së me ligjin nr. 38/2017 nuk kanë qenë të zbatueshme në rastin konkret. Po kështu, Gjykata e Lartë nuk ka njoftuar kërkuessit ose përfaqësuesit e tyre për datën dhe orën e seancës në dhomën e këshillimit, pasi njoftimi me shpallje në faqen e saj zyrtare edhe nëse është

kryer, nuk përmbush standardin e njoftimit efektiv. Gjithashtu, Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë zgjidhje përfundimtare pretendimeve të palëve. Rekursi dhe kundërrekursi i palëve ndërgjyqëse janë shndërruar në *mjete joefektive ankimi*, pasi paditësve u është njohur një e drejtë e cunguar, e drejta e pronës, por jo posedimi i saj, kurse kërkuesve, ndonëse nuk u ka njohur të drejtën e pronës, *de facto* dhe *de jure* u ka njohur më shumë të drejta sesa paditësve për sendin objekt gjykimi.

7.1.2. *Parimit të sigurtisë juridike dhe të pritshmërive të ligjshme*, pasi arsyetimi i vendimit të Gjykatës së Lartë, që në thelb nënkupton mosmarrjen në shqyrtim të pretendimit të kërkuesve për fitimin e pronësisë mbi truallin në mungesë të ngritjes së një padie ose kundërpadie nga ata, bie ndesh me qëndrimin e mbajtur në vendimin e saj unifikues nr. 5, datë 31.05.2011 (*vendimi unifikues nr. 5/2011*), në të cilin, në interpretim të padisë së rivendikimit, në objektin e së cilës përfshihej dhe detyrimi për njohjen pronar, është arsyetuar se “në raste të tilla nuk është parashkrimi i së drejtës së padisë shkak i rrëzimit të padisë, por është fakti se paditësi ka humbur të drejtën e tij të pronësisë për shkak se i padituri ka fituar të drejtën e pronësisë mbi sendin me parashkrim fitues”. Edhe në atë rast pretendimin për fitimin e pronësisë me parashkrim fitues i padituri nuk e ka ngritur me padi ose kundërpadi, por përmes prapësimeve. Për rrjedhojë, ndërsa nuk mund të njiheshin pronarë në dispozitivin e vendimit për shkak të mosngritjes nga ata të një padie ose kundërpadie, Gjykata e Lartë duhet të evidentonte fitimin e pronësisë nga kërkuesit dhe të përcaktonte se ky shkak passillte humbjen nga paditësit të së drejtës së pronësisë së truallit objekt gjykimi.

7.2. *Të drejtën e pronës*, pasi disponimi i Gjykatës së Lartë nuk mbështetet në asnjë dispozitë ligjore, është në kundërshtim me konkluzionet e vendimit të saj unifikues nr. 5/2011 dhe në keqinterpretim të nenit 175, paragrafi 4, të KC-së. Ata e kanë fituar pronësinë mbi ndërtesën në vitin 2002 dhe, për rrjedhojë, kanë fituar po në këtë moment edhe pronësinë mbi truallin në bazë të nenit 175, paragrafi 4, të KC-së, pra përpara se paditësit të vinin në lëvizje procesin gjyqësor.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuesve

8. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

9. Lidhur me legjitimitetin *ratione personae*, në jurisprudencën e saj Gjykata ka pohuar se, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, individi duhet të provojë interesin e tij, si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial, pasi si subjekt i kushtëzuar ai mund të bëjë kërkesë në Gjykatë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejta (*shih vendimet nr. 29, datë 16.04.2024; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Në rastin konkret, kërkuessit kanë pretenduar cenimin e së drejtës së aksesit edhe me argumentin se Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë zgjidhje përfundimtare pretendimeve të palëve, përfshirë edhe të paditësve për kërkimet e padisë për lirim dhe dorëzimin e tokës, si dhe pagimin e vlerës së përdorimit të saj. Kolegji vëren se pretendimi për këtë argument ka të bëjë me të drejtat të personave të tjerë (paditësit), ndaj kërkuessit nuk legjitimohen *ratione personae*, pasi nuk provojnë interesin e ligjshëm vetjak të tyre. Ndërsa për pretendimet e tjera Kolegji çmon se kërkuessit legjitimohen *ratione personae*, pasi kanë qenë palë në procesin gjyqësor të kundërshtuar dhe kanë interes të drejtpërdrejtë në çështjen e paraqitur.

11. Në lidhje me *shterimin e mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, kërkuessit kundërshtojnë vendimin e Gjykatës së Lartë, i cili ka përmyllur procesin gjyqësor dhe për të cilin ata nuk kanë më mjete të tjera efektive në dispozicion për të mbrojtur të drejtat e tyre, ndaj ata e plotësojnë këtë kriter.

12. Lidhur me legjitimitetin *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë i kundërshtuar nga kërkuessit mban datën 28.01.2025, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 26.05.2025, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

13. Në lidhje me legjitimitetin *ratione materiae*, në referim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, si dhe nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, kontrolli kushtetues ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes të të drejtave dhe lirive themelore të garantuara në Kushtetutë, kur pasojat negative janë të drejtpërdrejta dhe reale për

kërkuesin dhe kur shqyrtimi kushtetues i çështjes mund të rivendosë të drejtën kushtetuese të shkelur.

14. Në kërkesën e tyre kërkuesit kanë pretenduar cenimin e *së drejtës së aksesit dhe së drejtës për t'u dëgjuar*, duke parashtruar se Gjykata e Lartë nuk e ka shqyrtuar çështjen sipas procedurës së parashikuar nga ligji i kohës në momentin e paraqitjes së kërkesëpadisë, pra në seancë gjyqësore publike, në prani të palëve (përfaqësuesve të tyre), por ka ndjekur procedurën e gjykimit sipas ligjit në fuqi në kohën e shqyrtimit të çështjes, në një kohë kur ndryshimet e bëra KPC-së me ligjin nr. 38/2017 nuk kanë qenë të zbatueshme në rastin konkret. Po sipas tyre, Gjykata e Lartë nuk i ka njoftuar ata ose përfaqësuesit e tyre për datën dhe orën e seancës në dhomën e këshillimit, pasi njoftimi me shpallje në faqen e saj zyrtare edhe nëse është kryer, nuk përmbush standardin e njoftimit efektiv.

15. Referuar dokumenteve bashkëlidhur kërkesës, Kolegji konstaton se çështja e kërkuesve është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 11.10.2017, mbi bazën e rekursit të palës së tyre kundërshtare, ndërsa ata, pasi janë njohur me të, kanë paraqitur kundërrekurs. Ndërsa çështja ka qenë në pritje për t'u gjykuar, në datën 24.07.2024 kërkuesit kanë paraqitur kërkesë për përshpejtimin e gjykimit, e cila është pranuar dhe në datën 24.12.2025 ajo është planifikuar për shqyrtim në dhomën e këshillimit të datës 15.01.2025. Njoftimi për zhvillimin e saj është bërë me shpallje publike, duke u publikuar edhe në faqen zyrtare të asaj gjykate. Në vijim, çështja është shqyrtuar në datën e planifikuar dhe asnjë nga palët nuk ka paraqitur parashtrime me shkrim përpara seancës. Në përfundim të shqyrtimit në dhomën e këshillimit mbi bazë të dokumenteve, Gjykata e Lartë ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

16. Kolegji vëren se forma e gjykimit e zbatuar nga Gjykata e Lartë, në rastin konkret ajo në dhomën e këshillimit mbi bazë të dokumenteve, është forma që neni 482, pika 1, i KPC-së parashikon se zbatohet si rregull nga ana e asaj gjykate. Kjo dispozitë është ndryshuar me ligjin nr. 44/2021, i cili ka hyrë në fuqi në datën 29.05.2021, në dispozitën kalimtare të të cilit, ndër të tjera, është parashikuar se procedura e gjykimit në Gjykatën e Lartë rregullohet sipas përcaktimeve të këtij ligji. Për sa i përket zbatimit të ligjit procedural, Gjykata është shprehur se përveç rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe, ai zbatohet menjëherë në përputhje me parimin *tempus regit processum*. Në të drejtën procedurale, ligji i ri ka fuqi edhe për çështjet që janë në gjykim, me përjashtim të rastit kur vetë ai shprehet ndryshe (*shih vendimet nr. 41, datë 22.12.2022; nr. 3, datë 11.02.2021; nr. 11, datë 23.04.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, Gjykata është shprehur se shqyrtimi i çështjes nga Gjykata e Lartë në seancë në dhomën e këshillimit mbi bazë të dokumenteve dhe pa praninë fizike të palëve, nuk pengon debatin mes palëve në kuadër të së drejtës për t'u dëgjuar, i cili realizohet njësoj, pavarësisht formës së

paraqitjes së argumenteve me shkrim dhe shkëmbimit respektiv dhe në kohën e duhur të parashtrimeve (*shih vendimet nr. 26, datë 09.04.2024; nr. 9, datë 27.02.2024; nr. 41, datë 22.12.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Po kështu, Kolegji vëren se njoftimi për shqyrtimin e çështjes nga Gjykata e Lartë përmes shpalljes dhe publikimit në faqen e saj zyrtare, i zbatuar nga ajo gjykatë në rastin konkret, është mënyra kryesore e njoftimit që parashikon neni 482, pika 3, i KPC-së. Nga ana tjetër, edhe pse nga kërkuesit nuk pretendohet, njoftimi elektronik individual që kjo dispozitë parashikon në shtesë të mënyrës kryesore të njoftimit, nuk duket se ka qenë e zbatueshme në rastin konkret në kushtet kur kërkuesit dhe përfaqësuesi i tyre nuk kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit. Nga ana tjetër, në lidhje me efektivitetin e njoftimit me shpallje sipas nenit 482, pika 3, të KPC-së, Kolegji vëren se kjo normë i është nënshkruar kontrollit kushtetues mbi bazën e një ankimi kushtetues individual dhe Gjykata është shprehur se norma parashikon njoftimin me shpallje të palëve për procesin që zhvillohet në Gjykatën e Lartë, duke mos parashikuar njoftimin individual të tyre, përveçse kur ato kanë depozituar të dhënat elektronike, mënyrë njoftimi kjo që ndërhyr në të drejtën e aksesit në gjykatë të lidhur me të drejtën e mbrojtjes efektive. Megjithatë, kjo ndërhyrje është në përputhje me kriteret e nenit 17 të Kushtetues, pasi është bërë me ligj, për një interes publik dhe është në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. Mënyrat e njoftimit të parashikuara nga ligji përbëjnë një mjet efektiv për qëllimin e synuar dhe duke qenë një masë e arsyeshme dhe e përshtatshme ajo nuk e shndërron kufizimin e së drejtës së aksesit të lidhur me atë të mbrojtjes efektive, në arbitrar, për sa kohë që nuk cenohet thelbi i saj (*shih vendimin nr. 34, datë 12.06.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Për rrjedhojë, në kushtet kur kërkuesit kanë qenë në dijeni se çështja e tyre ka qenë për shqyrtim në Gjykatën e Lartë, ndërsa ata kanë ushtruar të drejtën e kundërrekursit, përveçse kanë kërkuar edhe përshpejtimin e gjykimit të saj, si dhe kur për njoftimin e tyre janë respektuar kërkesat e ligjit procedural dhe ata kanë pasur të gjitha mundësitë për të paraqitur argumente me shkrim përpara zhvillimit nga Gjykata e Lartë të seancës në dhomën e këshillimit mbi bazë të dokumenteve, Kolegji vlerëson se kërkuesit nuk kanë arritur të argumentojnë se përse kjo mënyrë e të vepruari nga Gjykata e Lartë u ka cenuar atyre të drejtën e aksesit dhe të drejtën për t'u dëgjuar, si dhe për t'u mbrojtur, ndaj ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim.

19. Në kërkesën e tyre, kërkuesit kanë pretenduar cenimin e së drejtës së aksesit edhe me argumentin se Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë zgjidhje pretendimit të tyre për fitimin e pronësisë sipas nenit 174, paragrafi 4, i KC-së. Kolegji konstaton se ky argument lidhet edhe me pretendimet e kërkuesve për cenimin e parimit të sigurisë juridike dhe pritshmërive të ligjshme dhe të së drejtës së pronës. Sipas kërkuesve, në respektim të parimit të sigurisë juridike

dhe pritshmërive të ligjshme, duke mbajtur në konsideratë vendimin e saj unifikues nr. 5/2011, Gjykata e Lartë duhej të zgjidhte pretendimin në fjalë të tyre, pasi mungesa e ngritjes nga ata të një padie ose kundërpadie nuk e pengonte atë gjykatë për t'i njohur pronarë të truallit në ndërtesë qoftë edhe duke e evidentuar këtë në pjesën arsyetuese të vendimit, krahas përcaktimit se fitimi nga ata i pronësisë mbi truallin passillte humbjen nga paditësit të kësaj të drejte. Pra, në thelb, kërkuesit pretendojnë se Gjykata e Lartë, në respektim të vendimit të saj unifikues nr. 5/2011, duhej të zgjidhte pretendimin e tyre për fitimin e pronësisë sipas nenit 175, paragrafi 4, të KC-së dhe për sa kohë nuk e ka zgjidhur, u ka cenuar atyre të drejtën e aksesit të lidhur me parimin e sigurisë juridike dhe pritshmërive të ligjshme dhe si pasojë e një procesi të tillë të parregullt u ka cenuar edhe të drejtën e pronës.

20. Në drejtim të së drejtës së aksesit, Gjykata është shprehur se ajo përfshin të drejtën e individit për të vënë në lëvizje gjykatën, por edhe të drejtën për të pasur prej saj një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi (*shih vendimet nr. 32, datë 19.05.2025; nr. 22, datë 29.04.2021; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, e drejta për t'iu drejtuar një gjykate nuk është absolute dhe ajo mund të jetë objekt i kufizimeve, me kusht që të mos cenohet thelbi i së drejtës (*shih vendimet nr. 34 datë 12.06.2023; nr. 67, datë 17.11.2015; nr. 7, datë 27.02.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). KPC-ja parashikon një tërësi rregullash parimore dhe specifike, si parakushte për realizimin e së drejtës së aksesit në gjykatë, ndër to edhe të drejtën për të ngritur padi në gjykatë, e cila nuk procedon me nismën e vet (*shih vendimet nr. 29, datë 15.05.2014; nr. 18, datë 08.07.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Përdorimi i mjetit procedural të përshtatshëm ankimes, në formë e në përmbajtje, siç sanksionohet në legjislacionin procedural, nuk përbën një kërkesë formale, por një kërkesë që lidhet me thelbin e së drejtës së mbrojtjes dhe të pjesëmarrjes aktive në gjykim, ku, në përputhje me këtë, neni 31 i KPC-së e ka përkufizuar padinë si të drejtën për t'u dëgjuar të personit që ngre pretendimin, në mënyrë që gjykata ta shpallë atë të bazuar ose jo në fakte e në ligje (*shih vendimet nr. 22, datë 29.04.2021; nr. 38, datë 30.06.2014; nr. 5, datë 20.03.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Ndërsa për parimin e sigurisë juridike Gjykata ka pohuar se ai nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit të shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin (*shih vendimet nr. 47, datë 11.06.2024; nr. 17 datë 23.03.2023; nr. 11, datë 16.04.2018 të Gjykatës Kushtetuese*). Po sipas saj, Kushtetuta i ka dhënë Gjykatës së Lartë autoritetin të njësojë ose të ndryshojë praktikën gjyqësore për të siguruar uniformitetin e interpretimit të normave ligjore nga ana e gjyqtarëve të zakonshëm, përmes përcaktimit të linjave të interpretimit të cilave gjyqtarët duhet t'u përmbahen. Përfundimet në të cilat arrin Gjykata e Lartë nuk vlejnë vetëm për rastin konkret të zgjidhur prej saj, por për të gjitha rastet e ngjashme për gjykatat e tjera ose vetë kolegjet e asaj gjykate. Një vendim unifikues ose

njësues i Gjykatës së Lartë në drejtim të zbatimit të ligjit material ose procedural për një çështje të caktuar sjell pritshmëri për individin se ligji do të zbatohet dhe do të interpretohet në mënyrë uniforme, siç është njësuar me vendimin unifikues të Gjykatës së Lartë për të njëjtën çështje ligjore (shih vendimet nr. 47, datë 11.06.2024; nr. 14 datë 21.03.2023; nr. 47, datë 03.07.2017 të Gjykatës Kushtetuese).

22. Nga ana tjetër, Gjykata në vijimësi ka theksuar se problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nga gjykatat e zakonshme nuk përfshihen në juridiksionin kushtetues, nëse nuk shoqërohen me cenimin e të drejtave kushtetuese (shih vendimet 32, datë 13.05.2025; nr. 6, datë 16.02.2021; nr. 9, datë 26.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese) dhe se detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të këtyre të drejtave, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Thënë ndryshe, ajo vepron në rastin kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (shih vendimet nr. 64, datë 01.10.2024; nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 33, datë 14.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese).

23. Në rastin në shqyrtim, Kolegji konstaton se procesi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkuesit është vënë në lëvizje mbi padinë e palës së tyre kundërshtare. Pretendimin për fitimin e pronësisë mbi truallin nën ndërtesë, sipas nenit 175, paragrafi 4, të KC-së, kërkuesit duket se e kanë ngritur vetëm përpara gjykatës së apelit gjatë parashtrimeve për ankimin e tyre. Gjykata e apelit, pa ndonjë arsyetim specifik për përshtatshmërinë e mjetit të përdorur nga kërkuesit për parashtrimin e këtij pretendimi, e ka marrë parasysh atë, duke arritur në përfundimin se kërkuesit praktikisht dhe ligjërisht janë bërë pronarë edhe të tokës, ndaj nuk mund të detyroheshin të njihnin pronarë persona të tjerë, as të lironin dhe dorëzonin atë dhe as të paguanin vlerën e saj, ku mbi këtë bazë ka rrëzuar padinë e kundërdrejtuar atyre. Kjo mënyrë e të vepruari nga gjykata e apelit në vijim është vlerësuar në kundërshtim me ligjin procedural nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë dhe konkretisht në shkelje të parimit të disponibilitetit, duke e argumentuar këtë me faktin se kërkuesit nuk kanë paraqitur padi ose kundërpadi për njohjen e së drejtës së pronësisë mbi truallin për shkak të tejkalimit të vlerës së ndërtesës të ndërtuar mbi të, arsye për të cilën pretendimi i tyre nuk mund të merrej në shqyrtim.

24. Po kështu, Kolegji vëren se në vendimin unifikues nr. 5/2011 të referuar nga kërkuesit, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë shtruar për njësim çështjen ligjore të parashkrimit shues të padisë së rivendikimit ose të kërkit të sendit (*actio rei vindicatio*), të parashikuar nga neni 296 i KC-së, duke arritur në përfundimin se kjo padi, për nga natyra e saj, është e paparashkrueshme. Në këtë vendim unifikues, qoftë në sentencën njëseuese, ashtu

edhe në argumentet e parashtruara në funksion të arritjes së saj, për asnjë moment nuk është vënë në diskutim fitimi i pronësisë me bashkim sipas nenit 175, paragrafi 4, të KC-së dhe aq më pak për mjetet ligjore për njohjen dhe mbrojtjen e kësaj të drejte të fituar në atë mënyrë. Edhe citimi i bërë nga kërkuesit në vendimin unifikues në fjalë, sikundër lehtësisht kuptohet, është pjesë e një prej argumenteve të parashtruara nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në funksion të sentencës unifikuese dhe ka të bëjë me pabazueshmërinë në themel të një padie rivendikimi në rastin kur paditësi ka humbur të drejtën e pronësisë për shkak të fitimit të saj nga i padituri me parashkrim fitues (me ose pa titull), por duke mos i marrë ato përsipër as në këtë rast të arsyetojnë për mjetet ligjore që mund të përdorë i padituri për të adresuar pretendimet e tij për njohjen dhe mbrojtjen e asaj të drejte.

25. Referuar standardeve kushtetuese të mësipërme dhe rrethanave të rastit konkret, Kolegji vëren se argumenti i paraqitur nga kërkuesit për të drejtat e pretenduara si të cenuara, në thelb, kanë të bëjnë me çështje të interpretimit dhe zbatimit të ligjit nga gjykatat e zakonshme, të cilat, për sa i përket gjykatës së apelit dhe Gjykatës së Lartë, janë ndarë në qëndrimet e tyre për shqyrtimin në mungesë të një padie ose kundërpadie, të pretendimit të kërkuesve për fitimin e pronësisë mbi truallin objekt gjykimi. Megjithatë, Gjykata e Lartë ka arsyetuar qëndrimin e saj për papërshtatshmërinë e mjetit procedural të përdorur nga kërkuesit për adresimin e pretendimit të tyre, duke orientuar praktikisht paraqitjen nga ata të padisë. Kolegji çmon të evidentojë se vërtet mosmarrëveshja e pronësisë mes palëve në rastin konkret nuk ka marrë zgjidhje përfundimtare për të gjitha aspektet e saj, përfshirë edhe për sa kërkuesit pretendojnë, por, megjithatë, referuar edhe vendimit të Gjykatës së Lartë, duket se ata kanë mjete ligjore në dispozicion për zgjidhjen e pretendimit të tyre. Në këtë kontekst, kërkuesit nuk kanë arritur të argumentojnë se zbatimi i ligjit procedural nga Gjykata e Lartë është arbitrar në kuptimin që gabimi i saj të jetë aq i dukshëm sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që e bën gjykimin të padrejtë. Ndërkohë argumenti i kërkuesve se mënyra e zgjidhjes së mosmarrëveshjes në rastin konkret u ka njohur atyre më shumë të drejta sesa paditësve, nuk mund të shërbejë për të provuar shkeljen e pretenduar të së drejtës së aksesit. Për rrjedhojë, pretendimet e kërkuesve për cenimin e së drejtës së aksesit, parimit të sigurisë juridike dhe pritshmërive të ligjshme, si dhe së drejtës së pronës private nuk mund të merren në shqyrtim.

26. Në përfundim, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, bazuar në nenet 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “b” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.